

Kthim pergjigje nr.167

Mon 4/6/2020 7:16 PM

To: Anxhela Ruci <anxhelaruci@faktoje.al>;

Përshëndetje Zj. Ruci!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 167, në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Kontrollet e kryera në terren, periudha 14 Mars-3 Prill 2020.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka vendosur në dispozicion të qytetarëve numrin e telefonit 0800 14 14 për të denoncuar çdo rast shkelje.

Nga data 14 deri në datë 31 Mars, kanë mbërritur 314 denoncime kryesisht të lidhura me fenomenin e abuzimit me çmimet nga ana e subjekteve.

Për këtë arsye, Drejtoria e Hetimit Tatimor me strukturat e monitorimit në varësi të saj, ka garantuar bashkëpunim dhe me struktura të tjera ligjzbatuese si Krimi Ekonomik, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit apo dhe me Agjensinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Këto struktura në bashkëpunim ndërmjet tyre kanë kryer verifikime në terren në ndjekje të të gjitha rasteve të denoncimeve të mbërritura pranë administratës tatimore.

Për të garantuar përmbushjen vullnetare të subjekteve dhe funksionimit të tyre në konform të procedurave të parashikuara në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.Sh”, i ndryshuar, strukturat e monitorimit në terren nga data 14 Mars deri në datë 3 Prill 2020 kanë kryer 361 kontrolle dhe kanë konstatuar 262 shkelje të legjislacionit tatimor. Pra, afërsisht 73% e kontrolleve të kryera kanë rezultuar me shkelje të legjislacionit tatimor, për të cilat janë vendosur penaltete.

Në përgjigje të çështjes së parë, pasqyrohen në vijim të gjitha llojet e masave të ndërmarra nga grupet e punës gjatë kontrolleve në terren:

Llojet e shkeljeve të legjislacionit tatimor:	Numer
Mallra te pashoqeruara me fature tatimore (gjobe 100% TVSH munguar)	89
Mosleshim kuponi tatimor (rasti pare bi)	43
Nuk mban dokumentacion tatimor, libra, BV	21
Leshon kupon me elemente jo te percaktuar sipas ligjit	18
Mosafishim te listes se çmimeve BV	15
Referim per Sektorin e Hetimit Tatimor	12

Administrim blloqesh/faturash jo tatimore	11
Nuk miremban pajisjen fiskale ne gjendje pune	10
Subjekt I parregjistruar ne organin tatimor	9
Mosafishim te listes se çmimeve BM	7
Nuk instalon pajisje fiskale (hera e pare ai)	7
Punonjes i padeklaruar Biznes i Vogel	7
Leshon kupon me vlere te ndryshme nga çmimi deklaruar	3
Mosleshim kuponi tatimor (rasti dyte bii)	2
Mosperditesim te dhena per rregjistrim, BV	2
Shitje pa fature tatimore	2
Leshon fature te pasakte tatimore (pa efekt detyrimi)	1
Mosperditesim te dhena per rregjistrim BM	1
Nuk mban dokumentacion tatimor, libra, BM	1
Punonjes i padeklaruar Biznes i Madh	1
Total	262

Në përgjigje të çështjes së dytë, ju vendosim në dispozicion informacionin mbi numrin e kontrolleve të kryera dhe numër të shkeljeve sipas llojit të biznesit, si më poshtë:

- ✓ Për tatimpagues të tatimit mbi fitimin, janë ushtruar 190 kontrolle dhe janë konstatuar 86 shkelje të legjislacionit tatimor;
- ✓ Për tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe TVSH, janë ushtruar 96 kontrolle dhe janë konstatuar 99 shkelje të legjislacionit tatimor.
- ✓ Për tatimpagues të tatimit te thjeshtuar mbi fitimin, janë ushtruar 53 kontrolle dhe janë konstatuar 68 shkelje.

Nga kontrollat në terren janë konstatuar dhe 9 subjekte me aktivitet si ushqimore apo tregti fruta perime, të paregjistruara në QKB dhe organet tatimore, për të cilat është marrë masa e bllokimit të aktivitetit deri në momentin që këto subjekte të përmbushin detyrimin për t'u regjistruar konform ligjit në fuqi.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Kthim pergjigje nr.167 Tue 4/7/2020 4:07 PM

To: Anxhela Ruci <anxhelaruci@faktoje.al>;

Pershendetje Zj. Ruci!

Referuar kerkeses ne vijim dhe bazuar ne rezultatet e kontrolleve ne terren te kryera deri ne date 3 Prill sipas materialit te percjelle paraprakisht per ju, ju bej me dije se per te gjitha subjektet e penalizuara jane marre masa sipas ligjit per procedurat tatimore ne fuqi. Per subjektet e kontrolluara jane marre kopje te faturave te blerjes se mallit per periudha te ndryshme dhe jane derguar per ndjekje dhe vleresime te metejshme prane Drejtorive Rajonale Tatimore perkatese.

Gjithashtu nje pjese e madhe e kontrolleve ne terren jane kryer dhe ne bashkepunim me struktura te tjera ligjzbatuese ne kuader te Task-Forces Nderinstitucionale, si Krimi Ekonomik, Autoriteti Kombetar i Ushqimit dhe Agjensia Kombetare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekesore, te cilet kane marre masa per subjektet ne perputhje me fushen perkatese te legjislacionit te tyre.

Faleminderit per mirekuptimin.